

**-Falja e sabahut me xhemat:** "Kush e falë namazin e sabahut, ai është nën mbrojtjen e All-llahut, andaj mos t'i kundërvihet askush kësaj (mbrojtjeje) me diçka, sepse kush i kundërvihet kësaj, do ta arrijë atë All-llahu, dhe pastaj do ta gjuajë atë në zjarr të Xhehennemit" (Muslimi).

**-Kujdesi para se të hyjmë në namaz:** "Kush e plotëson zbrazëtirën në saff, All-llahu për këtë do ta ngrit një shkallë dhe do t'i ndërton një shtëpi në Xhennet" (Sahih Et-Tergib vet-Terhib).

**-Dhikri i mëngjesit:** "Shembulli i atij i cili e bën dhikër Zotin e tij dhe i atij i cili nuk bën dhikër Zotin e tij, është sikurse shembulli i të gjallit dhe i të vdekurit" (Buhariu).

**-Namzi duha:** "Për çdo mëngjes, për çdo nyje tuajën jepet sadaka. çdo tesbih është sadaka, çdo tahmid është sadaka, çdo tehlil është sadaka, çdo tekbir është sadaka, urdhëri për punë të mirë është sadaka, ndalimi i së keqes është sadaka. Për këto do t'u mjaftojnë dy rekate, të cilat falen në namazin e paraditës-duhasë" (Muslimi).

**-Leximi i Kur'anit:** "Lexojeni Kur'anin, vërtet ai do të ndërmjetësojë Ditën e Gjykimit për të zotët e vet" (Muslimi).

**- Namazi i drekës, ikindisë dhe akshamit me xhemat:** "Kush e lë namazin e ikindisë i humb e tërë pasuria e tij" (Buhariu). "Ndihma e All-llahut është me xhematin" (Tirmidhiu).

**-Dhikri i mbrëmjes:** "A dëshironi t'ju tregoj për veprën tuaj më të mirë, më të dashur te Sunduesi i juaj, me të cilën fitoni shpërblimet më të larta tek Ai, veprën më të mirë se sa të shpënzoni ari dhe të holla, dhe më të mirë se sa të luftoni armikun? Dhikri (përkujtimi) i All-llahut!" (Tirmidhiu).

**-Namazi i jacisë me xhemat:** "Kush e falë namazin e jacisë më xhemat, është sikurse ta

ketë falur gjysmën e natës vetëm, ndërsa kush e falë namazin e jacisë dhe të sabahut me xhemat, është sikurse të jetë falur vetëm tërë natën" (Tirmidhiu).

**-Namazi i vitrit:** "Vërtet All-llahu është tek (vitr) dhe Ai e do tekun, prandaj faleni namazin e vitrit, o ju të zotët e Kur'anit!" (Muttefekun alejhi).

**- Namazi i natës:** "Njerëzit më të urrejtur tek All-llahu janë ata që janë të vrazdhët, të ashpër. Të dhënë pas kësaj bote, coftina të natës, gomarë të ditës, dijetarë për këtë botë, injorant për atë tjetrën (ahiretin)".

**-Tevbe-istigfar (pendimi dhe kërkimi i faljes së mëkateve):** "Kush pendohet para se të lind Dielli nga Perëndimi, All-llahu do ta falë" (Muslimi).

"Ai që pendohet nga mëkati është si ai që nuk ka bërë mëkat fare" (Ibn Maxhe).

**-Agjërimi vullnetar:** "Agjërimi mbron nga morali i keq, sepse ai që agjëron nuk flet gjëra të turpshme dhe nuk bërtet. Nëse (eventualisht) e shanë ndokush ose e sulmon le të thotë: 'Unë agjëroj, unë agjëroj.'" (Buhariu dhe Muslimi).

**-Bamirësia ndaj prindërve:** "Mëkatet e mëdha janë: All-llahut nëse i përshkruhet shok (shirk), mosdëgjimi i prindërve, vrasja e njeriut dhe betimi i rrejshëm (kur të bëhet më qëllim dhe me vetëdije)" (Buhariu).

**-Urdhërimi për punë të mira, ndalimi nga të këqijat:** "Kush nga ju sheh një të keqe le ta ndryshojë me dorën e tij, e nëse nuk mundet ta bëjë, atëherë me gjuhën e tij, e nëse nuk mund ta bëjë këtë-atëherë me zemrën e tij, porse ky është imani më i dobët" (Muslimi).

**-Përhapja e selamit:** "Nuk do të hyni në Xhennet derisa të besoni, dhe nuk do të besoni derisa të mos duheni mes veti. A nuk dëshitoni t'ju udhëzoj në një gjë, nëse e bëni atë do të duheni në mes veti? Përhapeni

selamin në mes jush!" (Muslimi).

**-Vizita e të sëmurit:** "Ai musliman i cili e viziton muslimanin në mëngjes, shtatëdhjetë mijë melekë do të luten për të deri në mbrëmje, e nëse e viziton pas akshamit dhe në kohën e jacisë, atëherë do të luten për të shtatëdhjetë mijë melekë deri në agim. Shpërblimi i tij do të jetë një pemë e veçantë, portokaj të vjelur" (Muslimi).

**-Kujdes në ruajtjen e sunnetit:** "Krejt ummeti im do të hyjë në Xhennet, përveç atij që nuk do". I thanë: "E kush nuk do, o i Dërguar i All-llahut?" Tha: "Kush më respekton mua, ai do të hyjë në Xhennet, ndërsa kush më kundërvihet (nuk më respekton), ai nuk do". (Buhariu).

**-Rekomandimi për kujdes ndaj grave:** "Më i ploti besimtar me iman është ai që është më i mirë në moral, kurse më të sjellshmit prej jush janë ata që janë më të sjellshëm ndaj grave të tyre" (Tirmidhiu).

**-E drejta e fqiu:** "Kush i beson All-llahut dhe Ditës së mbramë, mos ta shqetësojë fqinun e vet, kush i beson All-llahut dhe Ditës së mbramë le ta nderojë mikun (musafirin) e vet dhe kush i beson All-llahut dhe Ditës së mbramë, le të flasë mirë ose le të heshtë" (Muttefekun alejhi).

**-Mësimi diçka të re:** "Kush del nga shtëpia për shkak të kërkimit të diturisë, konsiderohet se është në rrugë të All-llahut derisa të kthehet nga rruga" (Tirmidhiu).

**-Largimi i mendjemadhësisë:** "Me tre lloj njerëzish All-llahu nuk do të flasë në Ditën e Gjykimit, nuk do t'ua falë e as s'do t'i mbrojë me mëshirën e Tij. Për ta është caktuar dënimi i rëndë e i dhembshëm. Ata janë: plaku që bën amoralitet, sunduesi që gënjen dhe i varfëri që është mendjemadh" (Muslimi).

**-Karakteret morali i mire:** Vërtet besimtari me karakter të mirë arrin gradën e atij që vazhdimisht agjëron dhe që fal namaz"

(Ebu Davudi).

**-Këshillimi:** "Askush nga ju nuk beson (plotësisht) përderisa nuk dëshiron për vëllain e vet atë që e dëshiron për vetveten" (Muttefekun alejhi)

**-Maturia në dëgjueshmëri:** "Vërtet feja është lehtësi, kushdo që e vështirëson fenë (me shtesa) ajo e ngadhënjën atë (duke e kthyer në gjendje normale), andaj drejtohuni, afrohuni (njëri me tjetrin), dhe përgëzoni, shfrytëzoni dhe ndihmoni me ecje të mëngjesit, të mbrëmjes dhe pasdarkës (shfrytëzoni lehtësimet fetare në ibadete)" (Buhariu).

**-Durimi-qëndresa (sabri):** "Kush e përmban zemërimin e atij atëherë kur ka mundësi t'ia kthejë (personit që e ka zemëruar), All-llahu në Ditën e Gjykimit do ta ftojë që para të gjitha krijesave ta zgjedhë cilën të dojë nga hyritë" (Ebu Davudi dhe Tirmidhiu)

**-Sinqeriteti:** "Sinqeriteti shpie në mirësi, kurse mirësia shpie në Xhennet. Vërtet njeriu i cili vazhdimisht është i sinqertë (në besim dhe në të folur), tek All-llahu shkruhet besimtar i vërtetë. Gënjeshtria shpie në prishje (morale), kurse prishja shpie në Xhehennem. Njeriu që gënjen vazhdimisht, më në fund tek All-llahu shkruhet gënjeshtar" (Muttefekun alejhi).

**-Modestia:** "Nuk është pasuri malli i shumtë, por pasuri është pasuria e shpirtit" (Muttefekun alejhi).

**-Urtësia, toleranca dhe butësia** "A doni t'ju tregoj se kujt i është ndaluar zjarri? Zjarri i është ndaluar atij që është njeri i afërt, i lehtë, i dashur, i sjellshëm dhe i butë" (Tirmidhiu).

| <b>Vepra e mirë</b>                          | <b>H</b> | <b>M</b> | <b>M</b> | <b>E</b> | <b>P</b> | <b>Sh</b> | <b>D</b> |
|--|----------|----------|----------|----------|----------|-----------|----------|
| Falja e sabahut me xhemat                    |          |          |          |          |          |           |          |
| Dhikri i mëngjesit                           |          |          |          |          |          |           |          |
| Leximi i Kur'anit                            |          |          |          |          |          |           |          |
| Namazi i duhasë                              |          |          |          |          |          |           |          |
| Falja e namazit të drekës me xhemat          |          |          |          |          |          |           |          |
| Falja e namazit të ikindisë me xhemat        |          |          |          |          |          |           |          |
| Dhikri i mbrëmjes                            |          |          |          |          |          |           |          |
| Namazi i akshamit me xhemat                  |          |          |          |          |          |           |          |
| Falja e namazit të jacisë me xhemat          |          |          |          |          |          |           |          |
| Namazi i vitrit                              |          |          |          |          |          |           |          |
| Namazi i natës                               |          |          |          |          |          |           |          |
| Teube-istigfar                               |          |          |          |          |          |           |          |
| Agjërimi vullnetar                           |          |          |          |          |          |           |          |
| Bamirësia ndaj prindërve                     |          |          |          |          |          |           |          |
| Urdhërimi në të mirë dhe ndalimi nga e keqja |          |          |          |          |          |           |          |
| Përhapja e selamit                           |          |          |          |          |          |           |          |
| Vizita e të sëmurit                          |          |          |          |          |          |           |          |
| Kujdes në ruajtjen e sunnetit                |          |          |          |          |          |           |          |
| Rekomandimi për kujdes ndaj grave            |          |          |          |          |          |           |          |
| E drejta e fjiut                             |          |          |          |          |          |           |          |
| Mësimi diçka të re                           |          |          |          |          |          |           |          |

Boton

Shoqata Qytetare Klubi Studentor

Rr. Stiv Naumov 7 / 18

Tel. ++389 (02) 223-654, 1000 Shkup



***Llogariteni  
veten para se  
të llogariteni!***

